

341.225.5

Mersel Bilalli¹

REGJIMET E DETIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

РЕЖИМИТЕ НА МОРЕТО ВО МЕЃУНАРОДНОТО ПРАВО

THE SEA REGIME IN THE INTERNATIONAL LAW

Abstract

At the present time all states claim to exercise sovereignty, subject to treaty obligations and rules of general international law, over a belt of sea adjacent to their coastlines. The sovereignty of the coastal state extends also to the seabed and subsoil of the territorial sea and the airspace over it.

An understanding of the modern law and the problems which remain unsolved must depend to a considerable extent on obtaining an historical perspective. In the eighteenth century extravagant claims to sovereignty over the sea were obsolete in many cases and were nearly so in other. Before the abandonment of such claims in the case of states which had not pursued extensive claims to the seas, and as a consequence of such abandonment in the cases, a test of appurtenance, a definition of the maritime marches of states, had to be sought.

In a work published in 1702 the Deutch jurist Bynkershock propounded the doctrine that the power of the territorial sovereign extended to vessels within the range of cannon mounted on the shore guns of ports and fortresses over adjacent waters: it was not originally a concept of a maritime belt of uniform breadth. However, in the latter half of the eighteenth century several states laid down limits for belts for purposes of customs or fishery control in legislation and treaties and

¹ Ligjërues në fakultetin juridik pranë Universitetit të parë privat FON.

Danish practice – after 1745 based on a four – mile belt as the extent of sovereignty – had some impact on the European thinking on the matter.

Abstrakt

Në kohën e tashme të gjitha shtetet pretendojnë të ushtrojnë sovranitet mbi një rrip të detit në afërsi të bregut të tyre, materie e cila është e rregulluar me norma të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Kështu, sovraniteti i shtetit bregor shtrihet edhe në një pjesë të shtratit të detit edhe në nëntokën e detit territorial edhe hapësirën ajrore mbi ta.

Kuptimi i të drejtës moderne dhe çështjet që mbeten akoma pa u zgjidhur, në masë të konsiderueshme duhet shtruar nga një shikim historik. Pretendimet ekstravagante të shekullit tetëmbëdhjetë lidhur me sovranitetin mbi detin tani më janë të tejkaluara, madje në shumë raste kemi diçka krejt tjetër. Paraprakisht, braktisja e pretendimeve të tilla u bë nga shtete të cilat vet nuk e kishin pretendime të gjera në det dhe si pasojë e braktisjes të tillë u shqyrtua dhe u ndërtua një identitet i ri i cili nënkuptonte kufizime të shteteve bregore.

Në një vepër të botuar në 1702 nga juristi Bynkershock Deutch promovohet doktrina se sovraniteti territorial mbi det duhet zgjeruar vetëm brenda distancës së hedhjes së një predhe topi të gjuajtur nga bregu, porti, fortesa apo ujërat e cekëta: por, kjo nuk paraqet një bazë të qëndrueshme mbi të cilin mund të thuhet se lindi koncept unanim mbi gjerësinë e rripit detar. Megjithatë, në gjysmën e dytë të shekullit të tetëmbëdhjetë disa shtete kishin përcaktuar kufijtë për rripin detar brenda të cilëve ushtronin kontroll doganor apo kontroll peshkimi ose legjislacioni dhe të traktateve, prej këtu me siguri se praktika daneze pas vitit 1745 se shtrirja e sovranitetit në katër mile detare - ka pasur ndikim në të menduarit për këtë çështje në Evropë.

Hyrje

Deti ka rëndësi të madhe në zhvillimin e ekonomisë së shteteve. Përmes tij realizohet transportimi më ekonomik i mallrave, sigurohet peshkimi, zhvillohet turizmi, kurse kohëve të fundit nga deti eksploatohen sasi të mëdha të naftës, gazit natyror dhe pasurive xeherore në

thellësi të mëdha të fund-detit. Ujërat detare,² shekuj me radhë janë konsiderua si pasuri e përbashkët apo e përgjithshme. Por, ka pasur tentime që detin ta trajtojnë si send i askujt (*res nullius*), duke synuar përvetësimin e sipërfaqeve të mëdha të deteve dhe oqeaneve. Tendencat për vënien nën sovranitet të hapësirave të gjëra detare, gjithherë kanë përfundua pa sukses. Spanja dhe Portugalia në mesjetë kanë synuar vendosjen e sovranitetit mbi oqeanin Atlantik, i cili pushtet për arsye praktike, pra të pamundësisë që të vihet pushtet efektiv, nuk ka pasur sukses. Hapësira detare përfshinë mbi 70 për qind të rruzullit tokësor. Ujërat detare i përbëjnë:

- 1) deti territorial;
- 2) rripi i jashtëm;
- 3) rripi epikontinental;
- 4) zona ekonomike ekskluzive;
- 5) deti i hapur; dhe
- 6) zona ndërkombëtare.

Deti territorial

Deti territorial nënkupton rripin detar bashkë me nëndetin dhe hapësirën ajrore, i cili shtrihet përgjatë bregdetit, kurse nga ana e detit shtrihet në gjerësi deri në 12 mile nautike,³ nga pika fillestare që përcaktohet për matjen e detit territorial në drejtim të detit të hapur.⁴ Kufiri i jashtëm i detit territorial njëherit është edhe kufiri shtetëror i shtetit bregor nga ana e detit.⁵

Për shkak të dallimeve në mes shteteve për gjerësinë e detit territorial, Konventa bën vetëm përcaktimin e maksimumit e gjerësisë së shtrirjes së detit territorial, që nënkupton, shtetet mund të definojnë gjerësi më të vogël. Zakonisht shtetet më të pazhvilluara dhe të vogla, me qëllim të ruajtjes së pasurive në det dhe sigurisë nacionale, insistojnë që deti territorial të jetë sa më i gjerë. Kurse, shtetet e

² Me nocionin “det” në të drejtën ndërkombëtare nënkuptohen detet dhe oqeanet.

³ Akoma ekzistojnë shtete sidomos të Amerikës Latine që pretendojnë në gjerësi të detit territorial prej madje 50 apo 100 mile. Por, Konveta detare e vitit 1982, parasheh maksimumin e shtrirjes së detit territorial prej 12 mile. Praktikisht, normat e kësaj konventë për këtë çështje tani janë të shndërruara në norma të përgjithshme zakonore.

⁴ John Colombos, *Derecho Internacional marítimo*, Madrid, 1961.

⁵ Gjerësisht shif, D.P. O’Connell, *International Law*, Vol. One, London, pp.461-465.

fuqishme insistojnë të kundërtën, pasi ata kanë potencial të nevojshëm teknologjik për eksploatimin e pasurive detare.

Në këtë pjesë të detit, shtetet ushtrojnë sovranitetin shtetërorë, por me një përkufizim që shtetet tjera kanë të drejtë *lundrimi të padëmshëm*⁶ nëpër detin territorial të shtetit bregor, qoftë si transit, apo hyrje dhe dalje në limanet e shtetit bregor. Lundrim i padëmshëm konsiderohet nëse synon sistemin juridik të shtetit bregor (përdorimi apo kërcënimi me forcë, ushtrime ushtarake, spiunimi, propaganda, ligjet fiskale, ndotja, peshkimi pa leje etj.). Në këto raste shteti bregor ka të drejtë përkohësisht të ndalon lundrimin në detin e vet territorial. Nëse është fjala për shkaktimin e dëmit nga anija e huaj luftarake, shteti flamurin e të cilit valon anija, ka për obligim ta kompensoi dëmin.⁷ Në këtë pjesë të detit, shteti bregor në raste të caktuara mund të ushtrojë juridiksion penal dhe civil ndaj anijeve të huaja tregtare, duke ushtrua proces gjyqësorë ndaj shkelësve të ligjeve vendase.

Rripi i jashtëm

Rripi i jashtëm nënkupton pjesën e detit të hapur që fillon të shtrihet prej linjës së jashtme të detit territorial në drejtim të detit të hapur në largësi gjer në 12 mile prej kufirit të jashtëm të detit territorial. Konventa e vitit 1982, përcakton se *rripi i jashtëm* nuk mund të shtrihet jashtë 24 mile/nautike, që nënkupton se nëse shteti bregor definton gjerësinë e detit territorial në 12 m/n, atëherë ai shtet ka të drejtë ta definoi rripin e jashtëm edhe 12 m/n tjera. Por, këtu shtetet tjera kanë të drejtë të lundrimit të lirë dhe kjo vlen për të gjitha anijet (edhe tregtare edhe luftarake). Ky rrip ka për qëllim mbrojtjen e interesave të shtetit bregor me karakter doganor, fiskal, sanitar, të emigracionit, mbrojtjes nga ndotja etj. Pra, këtu shteti bregor ushtron preventim dhe kontroll për parandalimin dhe dënimin e veprimeve kundërligjore. Përndryshe, hapësira e rripit të jashtëm ka statusin e detit të hapur. Ky nuk bien nën sovranitet të shtetit bregor.⁸

⁶ Freng. Passage inofensive; kroat,sreb. Neškodljiv prolazak.

⁷ Brownlie, *General Principles of Public International Law*, Oxford, 2001, 194 -195.

⁸ Shif, A.V. Lowe, *The Development of the Concept of the Contiguous Zone*, British Year Book of International Law, Vol, 52, 1981, p.109 etc.

Rripi kontinental

Rripi kontinental nënkupton fund-detin dhe nën-detin në detin e hapur, i cili fillon nga linja e jashtme e detit territorial dhe shtrihet gjatë gjithë vazhdimësisë natyrore⁹ ose gjer deri në largësi prej 200 mile. Kjo pjesë është vazhdimësi e pjesës kontinentale gjer në rrëpirën e prerë. Prandaj, në raste të caktuara brezi kontinental tejkalon gjerësinë prej 200 m/n. Në vitin 1945, kryetari Amerika Truman, bëri proklamimin e pasurive natyrore në gjerësinë e rripit kontinental, me çka edhe formalisht lindi instituti – rripi kontinental. Shteti bregor disponon me automatizëm me rrip kontinental, si bazë e konfiguracionit dhe vazhdimësisë së pjesës tokësore, Megjithatë, shteti bregor duhet të bëjë publike të gjitha detajet në lidhje me këtë pjesë të detit dhe t'i informon shtetet tjera.

Përndryshe, në shumë shtete, rripi kontinental është shumë i pasur me xehe nëntokësore dhe me rezerva të naftës dhe gazit natyror. Mbi këtë pjesë të detit shteti bregor ushtron të drejtë sovranë për shfrytëzimin e pasurive natyrore (pra, jo sovranitet, por të drejta sovranë). Këtu bëjnë pjesë pasuritë xeherore dhe pasuritë tjera jo të gjalla (nafta, gazi natyror), që gjinden në fund-det dhe nëntokën e fund-detit.¹⁰ Megjithatë, shteti bregor nuk mund të ndalojë që në rripin kontinental, shtetet tjera në konsultim me shtetin bregor të vënë kablo të largpërçuesve dhe gypave përçues (naftës, gazit etj.).

Nëse rripi kontinental i shtetit shtrihet gjer në brezin kontinental që mund t'i takon shtetit tjetër përballë, atëherë kufizimi në mes tyre bëhet me marrëveshje në me këtyre shteteve. Nëse nuk ekziston marrëveshje e tillë, atëherë si kufij në mes rripave kontinentale konsiderohet linja e mesme detare në barë të rrethanave specifike.¹¹

Zona ekonomike ekskluzive

Zona ekonomike ekskluzive paraqet institut të ri të së drejtës detare dhe nënkupton ushtrimin e të drejtave sovranë të shteteve bregore në lidhje me shfrytëzimin e pasurive të gjalla dhe jo të gjalla të detit në largësi prej 200 mile nga bregu (pika fillestare për matjen e

⁹ Rusia vazhdimisht ka pretendime ndaj një pjese të konsiderueshme të brezit territorial në Detin e Veriut, me argumentim se kjo pjesë paraqet “vazhdimi të shtrirjes kontinentale” të Siberisë.

¹⁰ Cahier, *Les Sources de Droit Relative la Délimitation du Olateau Continental*, Malenges Virally, 1991.

¹¹ Shif rastin, *Golf of Maine*, *ICJ Reports*, 1984, 299-300.

gjerësisë së detit territorial), duke përfshi këtu edhe nën-detin dhe shtyllën e ujit mbi te. Në këtë pjesë të detit gjinden mbi 90 për qind të rezervave të peshkut, naftës dhe gazit, krahasuar me pjesët tjera detare.¹²

Shteti bregor në këtë pjesë të detit ushtron të drejta sovraane në hulumtimin dhe shfrytëzimin optimal të pasurive të gjalla dhe jo të gjalla; ushtron juridiksionin në lidhje me mbrojtjen e llojeve biologjike dhe kujdesin nga ndotja; ushtron juridiksionin në lidhje me ndërtimin e ujdhesave artificiale; mund të shfrytëzon burimet energjike (rrymat detare, energjinë e erës), dhe të miraton ligje konform normave ndërkombëtare për veprimin e shteteve tjera në këtë zonë. Po ashtu edhe këtu, shtetet tjera pos që kanë të drejtë të lundrimit të lirë, ata mund të vendosin edhe kablllo-largpërçuese dhe gypa-përçues.¹³

Shteti bregor, nëse nuk mund t'i shfrytëzojë të gjitha potencialet e lejuara për gjuetinë e pasurive të gjalla në zonën e vet ekonomike ekskluzive, ai në bazë të marrëveshjes mund tu lejoj shteteve tjera fqinje, sidomos atyre jobregore apo atyre me gjendje të pavolitshme gjeografike, që të shfrytëzojnë tepriçën e pasurive të gjalla në këtë pjesë të detit.¹⁴

Ky institut edhe pse duket shumë i përafërt me brezin kontinental, dallohej për atë se nuk i takon shtetit bregor me automatizëm, por duhet të proklamohet, dhe më tepër ka të bëjë me pasuritë e gjalla se sa ato jo të gjalla. Shtetet pavarësisht vendosin se a do të proklamojnë zonë ekonomike ekskluzive apo jo.

Deti i hapur

Regjimit ë detit të hapur i takojnë e gjithë hapësira detare jashtë detit territorial. Madje, edhe rripi i jashtëm dhe ujërat sipërfaqësore të rripit kontinental dhe të zonë e ekonomike ekskluzive i takojnë detit të hapur, pasi në këto pjesë shtetet bregore ushtrojnë vetëm të drejta sovraane, e jo sovranitet. Deti i hapur është jashtë sovranitetit të shteteve dhe paraqet e mirë e përgjithshme e njerëzimit (*res communis omnium*).

Të gjitha insistimet e shteteve në të kaluarën që të vënë hapësira të gjëra detare nën sovranitet të vetin kanë dështuar. Kështu, Britania e Madhe ka pretendua sovranitet mbi Atlantikun verior dhe Detin e

¹² Shif, R. Davorin, *Medjunarodno pravo mora*, Zagreb, 1985, f. 197.

¹³ ICJ Reports, 1986, p. 111, paras. 213-214.

¹⁴ Gjërsishtë për ZEE, shif, B. Kwaitowska, *The 2000 Mile Economics Zone in the New Law of the Sea*, Dodrecht, 1989.

Veriut, Portugalia mbi Oqeanin Indian dhe Atlantikun jugor, Spanja mbi Paqësorin, Suedia mbi Baltikun, Rusia 100 m/n rreth Alaskës etj. Hugo Grociusi (Grotius), në veprën e vet *De iure praedae*, në pjesën *Mare liberum*, kundërshton tendencat e përvetësimit të hapësirave detare, duke potencuar se deti i hapur është i lirë dhe nuk mund të jetë nën sovranitet të asnjë shteti. Madje, edhe ata shtete që kanë bërë proklamime të tilla, jo vetëm që janë ndeshur me protesta të shteteve tjera, por ata edhe efektivisht nuk kanë mundur të zotërojnë këto hapësira të mëdha. Më vonë shumë autorë tjerë zhvillojnë tezën se deti i hapur i takon gjithë njerëzimit. Nuk kanë qëndrua as tezat e disa autorëve, të cilët detin e hapur e konsideronin send i askujt (*res nullius*), pasi sendi i askujt mund të përvetësohet.

Statusi i detit të hapur rregullohet me Konventën mbi Detin e Hapur (1958) dhe definitivisht me Konventën mbi të Drejtën Detare të vitit 1982. Në bazë të së drejtës ndërkombëtare, hapësira e detit të hapur ka statusin e detit të lirë dhe shtetet mund të:

- a. liria e lundrimit të të gjitha anijeve (tregtare dhe të luftarake);
- b. liria e peshkimit;
- c. liria e vënies së kabllove detare dhe gypave përçues detar;
- d. liria e fluturimit mbi detin e hapur;
- e. liria e ndërtimit të ishujve artificial; dhe
- f. liria e hulumtimeve shkencore.

Anijet që lundrojnë në detin e hapur duhet të jenë të regjistruara në ndonjë shtet dhe të mbajnë flamurin e shtetit apo të organizatës ndërkombëtare. Shteti i flamurit ushtron juridiksionin mbi anijet e veta në detin e hapur. Anijet pa flamur apo të dyshimta mund të ndiqen nga anijet luftarake të çdo shteti. Pra, kjo nënkupton se në raste të caktuara mund të ushtrohet edhe juridiksioni ndërkombëtar. Për shembull: a)në rast dyshimi se anija e caktuar merret me piratëri; b)në rast dyshime se anija merret me tregti me robër; c)nëse nuk mund të konstatohet përkatësia shtetërore e anijes; d)nëse anija merret me emetim të paautorizuar të sinjalit radioshpërndarës etj.

Piratëri konsiderohet çdo akt dhunë të paautorizuar¹⁵ të ndonjë anije jashtë kontrolli, ndaj anijeve tjera në detin e hapur. Zakonisht piratëria ka pëq qëllim plaçkitjen e mallrave dhe vlerave tjera nga anijet

¹⁵ J.C. Woodliffe, *The Demise of Unauthorised Broadcasting from Ships in International Waters*, *Jornal of Estuarine and Coastal Law*, 1986, p. 402.

tjera.¹⁶ Aktet e piratërisë konsiderohen si krime ndërkombëtare dhe shtetet i dënojnë rreptësisht (madje edhe me vdekje).

Zona ndërkombëtare

Me zhvillimin e teknologjisë së hulumtimit dhe eksploatimit të pasurive xeherore në thellësi shumë të mëdha, imponohet nevoja për definimin e statusit të pjesës tejte të madhe të detit, e cila gjindet jashtë juridiksionit të shtetit dhe emërohet si *Zonë Ndërkombëtare*. Zona ndërkombëtare paraqet institut të aplikuar me Konventën e vitit 1982, me ç'rast fund-deti dhe nëndeti jashtë juridiksionit shtetëror shpallet *si e mirë e përgjithshme e njerëzimit (res communis omnium)*.¹⁷ Sipas Konventës mbi të drejtën detare (1982), veprimtaritë në zonën ndërkombëtare duhet të ushtrohen në interes të të gjithë njerëzimit dhe se këto veprimtari mund të ushtrohen vetëm për qëllime paqësore. Askush nuk mund të vë sovranitet apo të përvetësoj pjesë të zonës dhe pasuritë në zonë i takojnë mbarë njerëzimit dhe të gjitha shteteve bregore dhe jobregore. Supozohet se këtu ekzistojnë pasuri xelesh 1000 herë më tepër se në pjesën tokësore të planetit.¹⁸ Shfrytëzimi i këtyre pasurive bëhet vetëm përmes rregullave të Pushtetit Ndërkombëtar (Authority), i cili vepron në emër të bashkësisë ndërkombëtare. Pushteti paraqet organizatë ndërkombëtare e përbërë nga të gjitha shtetet anëtare. Ai organizon, ushtron dhe mbikëqyr veprimtaritë në Zonë. Pushteti ka këto organe: Kuvendin, Këshillin dhe Sekretariatit., kurse për punë operative të eksploatimit të Zonës ekziston edhe Ndërmarrja Ndërkombëtare, e cila edhe vet mund të bëjë eksploatimin e pasurive në Zonë. Selia e Pushtetit gjendet në Xhamajkë.

Gjatë punës së harmonizimit të interesave të shteteve rreth miratimit të Konventës mbi të drejtën detare (1982), pozicionet e grupeve të shteteve të zhvilluara dhe atyre të pazhvilluara, si dhe atyre bregore dhe jobregore diametralisht ndesheshin. Vendet e zhvilluara të cilat kanë

¹⁶ Shif, B.H. Dubner, *The Law of International Sea Piracy*, The Hague, 1979.

¹⁷ Hapi më serioz për definimin e regjimit të fund-detit dhe nën-detit jashtë juridiksionit, bëhet me miratimin e Deklaratës mbi parimet e rregullimit të fund-detit dhe oqeanit jashtë juridiksionit nacional, i miratuar nga Asambleja e OKB-së në vitin 1970. Parimet e kësaj deklarata më vonë aplikohen në Konventën mbi të drejtën detare të vitit 1982.

¹⁸ Gjerësisht për pasuritë në Zonën ndërkombëtare, shih, M. Bilalli, *Drzhavite bez izlez na more i Megjunarodnata zona*, 2002, Shkup, punim i magistraturës.

teknologji për eksploatim në thellësi të mëdha insistonin në atë që Pushteti Ndërkombëtar të ketë autorizime më të vogla, kurse shtetet e pazhvilluara synonin të kundërtën. Shtetet jobregore ishin në pozitë më të pavoritshme për shumë çështje.

Pas përfundimit të punëve në lidhje me tekstin e Konventës, disa shtete të fuqishme, në rend të parë SHBA-të, refuzuan nënshkrimin e konventës, në të cilën ishte punuar më se dhjetë vjet. Një situatë e tillë pas 12 vitesh imponoi një kompromis plotësues, ku u patën bërë disa ndryshime në favor të shteteve të fuqishme, të cilat shtete më vonë pranuan të jenë anëtare të Konventës.

Shtetet jobregore

Shtetet pa bregdet janë të handikapuar, për shumë çështje, Ata nuk kanë det territorial, e as rrip kontinental apo zonë ekonomike ekskluzive. Shtetet bregore fituan të drejtën e shfrytëzimit të hapësirave të mëdha detare, vetëm për atë se kufizohen me det. Një shekull më herët nuk ekzistonte as koshiencë nga këto shtete për këto pjesë të detit. Shtetet jobregore janë handikapuara edhe sa i përket komunikacionit dhe lidhjeve me limanet detare dhe komunikacionin detar. Për këtë arsye prodhimet e tyre u nënshtrohen vonesave për në tregje tjera. Po ashtu, kur të kemi parasysh se transporti detar është shumëfish më i lirë dhe më ekonomik, mallrat e vendet jobregore nuk mund të jenë konkurrencte me prodhimet e vendeve bregore.

E drejta e transitit për shtete jobregore del nga disa parime të Kartës së Kombeve të Bashkuara, siç janë; e drejta e shteteve në ekzistencë; e drejta dhe obligimi në bashkëpunim; dhe e drejta në komunikacion të lirë ndërkombëtarë. Prandaj e drejta ndërkombëtare parasheh forma të ndryshme juridike për zbutjen e kësaj situatë. Prej këtu, Konventa për të drejtën detare e vitit 1982, parasheh të drejtën dhe lirinë e transitit të shteteve jobregore nëpër territorin e vendeve bregore dhe të drejtën e shfrytëzimit të lumenjve të shtetit fqinj bregor.¹⁹ Anijet e shtetit jobregor kanë tretman të barabartë me të atyre bregore. Transporti tranzitues nëpër territor të shtetit bregor është i liruar nga doganat dhe taksat e ndryshme, pos shpenzimeve të transportit dhe shpenzimeve administrative.

¹⁹ M. Bilalli, *Slobodata na moreto i pristap na Republika Makedonija do moreto*, 2007, Shkup, punim disertacioni.

Sipas Konventës mbi të Drejtën Detare (1982), shtetet jobregore fqinje kanë të drejtë në hulumtime shkencore në rripin kontinental dhe në zonën ekonomike ekskluzive të shtetit fqinjë bregor. Për këtë ata duhet vetëm ta njoftojnë shtetin bregor i cili sipas Konventës nuk do ta kundërshtonte këtë pa ndonjë arsye serioze. Por, shteti jobregor duhet t'u përmbahet dispozitave të Konventës dhe rregullativës së shtetit bregor. Po ashtu shtetet jobregore kanë të drejtë në shfrytëzimin e pasurive të gjalla detare në zonën ekonomike ekskluzive, por vetëm nëse ka tepriçë resurcesh të tilla që nuk mund t'i eksploatoi në tërësi vet shteti bregor. Edhe këtu shteti jobregor duhet t'u përmbahet dispozitave të Konventës mbi të drejtën detare.

Megjithatë, Konventa e vitit 1982, parasheh edhe obligime dhe përkufizime të caktuara, të cilat shtetet bregore mund t'i ndërmarrin si "masa të domosdoshme", nëse rrezikohen interesat legjitime të tyre.²⁰ Në këto masa bëjnë pjesë – aktivitetet në rast të cenimit të mbrojtjes dhe sigurisë të vendit bregor; respektimi i ligjeve të shtetit bregor; respektimi i standardeve sanitare për personat, botën bimore dhe shtazore etj.

Konkluzë

Ujërat e detit përfshijnë rreth 71 për qind të rruzullit tokësor. Deti tani mund të shfrytëzohet jo vetëm për lundrim e peshkim, por edhe për eksploatim të shumë resurseve të gjalla e jo të gjalla duke përfshirë edhe nxjerrjen e xeheve të ndryshme, naftës, gazit etj.

Mu për këtë deti si një sipërfaqe, si shtyllë uji, si fund-det dhe nëntokë e fund-detit kanë statusin juridik ndërkombëtar - *të mirat e përgjithshme të njerëzimit*. Kjo nënkupton se bashkësia ndërkombëtare duhet të ndërtojë mekanizma efikas për implementimin e këtij statusi ndërkombëtar, pa dallim se a është fjala për shtete me teknologjitë të zhvilluar, të afta për eksploatim apo për shtete të varfra e pa teknologji. Pra, të gjitha shtetet pa dallim kanë të drejtë në të mirat e detit, madje edhe ata shtete që nuk kanë bregdet. Prandaj edhe janë krijuar shumë regjime lidhur me të drejtën detare.

²⁰ Vasciannie, *Land-Locked an Geographicly Disadvantaged States in the International Law of the Sea*, 1990.

Conclusion

The sea waters cover about 71 percent of the Earth. Now the sea can be used not only for navigation and fishing, but also for more living and non-living resources exploitation including the extraction of various ores, oil, gas etc.

Therefore sea as a surface, like water column, as the sea bottom and subsoil of the sea bottom have international legal status - *the common heritage of mankind*. This means that the international community should build effective mechanisms for implementation of this international status, regardless of whether it comes to technologies developed countries capable for exploiting this sea resources or it comes for poor countries without technology. So all countries without distinction are entitled to the benefits of the sea, even the land locked countries. Therefore, many international law regimes have been created on the right to the sea.

LITERATURA

- Brownlie, *Qeneral Principles of Public International Law*, Oxford, 2001
- Cahier, *Les Sources de Droit Relatife la Délimitation du Olateau Continental*, Malenges Virally, 1991.
- Colombos J, *Derecho Internacional maritimo*, Madrid, 1961
- Davorin R, *Medjunarodno pravo mora*, Zagreb, 1985,
- Dubner B. H, *The Law of International Sea Piracy*, The Hague, 1979.
- Kwaitowska B, *The 2000 Mile Economics Zone in the New Law of the Sea*, Dodredcht, 1989
- Lowe V. A, *The Development of the Concept of the Contiguous Zone*, British Year Book of International Law, Vol, 52, 1981
- M. Bilallli *Republika Makedonija I pravoto na moreto*, FOOM, Skopje, 2012
- M. Bilalli, *Slobodata na moreto i pristap na Republika Makedonija do moreto*, 2007, Shkup, punim disertacioni
- M. Bilalli, *Dr`avite bez izlez na more i Mejunarodnata zona*, 2002, Shkup, punim i magjistraturës.
- O'Connell P. D, *International Law*, Vol. One, London
- Vasciannie, *Land-Locked an Geographicily Disadvantaged States in the International Law of the Sea*, 1990.

Woodliffe C. J, *The Demise of Unauthorised Broadcasting from Ships in International Waters*, *Jornal of Estuarine and Coastal Law*, 1986

Materiale tjera

ICJ Reports 1984

ICJ Reports, 1986

Konventa mbi të Drejtë Detare, 1982